



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

## KURRIKULA ME ZGJEDHJE

**Lënda: Sociologji**

**Shkalla: VI**

**Klasa: XII**

Tiranë 2017



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

## **Tabela e përmbajtjes**

### **1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”**

#### **1.1.Hyrje në programin e sociologjisë**

### **2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT**

#### **2.1.Qëllimet e programit të Sociologjisë**

#### **2.2.Lidhja e kompetencave të lëndës me kompetencat e tjera kyçe**

#### **2.3.Lidhja e lëndës së sociologjisë me temat ndërkurrikulare**

#### **2.4.Lidhjet e lëndës së sociologjisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit**

#### **2.5.Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj**

#### **2.6.Koha mësimore për tematikë, për secilën klasë**

### **3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN I, III**

### **4. UDHËZIME METODOLOGJIKE**

### **5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

### **6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE**

## 1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballlet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po rritet, për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje e globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën shoqëria dhe mjedisi zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një

shoqëri demokratike. Ato nxisin zhvillimin intelektual të nxënësit, duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilët nxënësi mund t'i përdorë në situata të ndryshme, e ndihmojnë të prezantojë botën dhe të përballojë situata të ndryshme në jetën e tij.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve qytetari, sociologji, ekonomi, filozofi, psikologji, histori, gjeografi. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme. Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillon konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Programet e lëndëve qytetari, sociologji, ekonomi, filozofi, psikologji, histori dhe gjeografi janë ngushtësisht të lidhura nga kompetencat që ato synojnë të zhvillojnë te nxënësi. Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni, në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

## 1.1 Hyrje në programin e sociologjisë

Programi i lëndës sociologjia përmban një tërësi konceptesh, njohurish dhe vlerash, të lidhura logjikisht me njëra-tjetrën, të cilat i ndihmojnë nxënësit e klasës XII, jo vetëm për të kuptuar e interpretuar më mirë dukuritë, proceset e prirjet e zhvillimit të shoqërisë, por edhe për t'u orientuar drejt në zgjidhjen e problemeve praktike të jetesës së përditshme.

Ky program kërkon dhe bazohet në përdorimin e analizave sociologjike për dukuritë e proceset e zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Shtjellimi i strukturave konceptuale përgjithësuese do të realizohet i gërshetuar me një profil kombëtar të spikatur.

Ndër konceptet kryesore që do të shtjellohen në kuadrin e këtij programi janë: metoda të kërkimeve sociologjike, eksperiment sociologjik, anketë, intervistë, vëzhgim sociologjik, kultura, simbol kulturor, vlerë kulturore, normë kulturore, kulturë materiale, subkulturë, kundërkulturë, etnocentrizëm, ksenocentrizëm, relativitet kulturor, shoqërizim, faza të procesit të shoqërizimit, deviancë, karakter relativ i deviancës, funksione sociale të deviancës, shpjegim biologjik i deviancës, shpjegim sociologjik i deviancës, dallim gjinor, shtresim gjinor, martesë, forma të martesës, familje, forma të reja të familjes në ditët tona, divorc, racë, etni, pakicë kombëtare, paragjykim racor ose etnik, diskriminimi racor ose etnik, përcaktim sociologjik i fesë, funksione sociale të besimeve fetare, fe botërore, shekullarizim, fundamentalizëm, karakteristika të punës në vendet më të industrializuara, urbanizim, metropol, megalopolis, zonë urbane, shpërqëndrim urban, ripërtëritje urbane, xhentrifikim, eksurbanizim, shtresim i shoqërisë, lëvizshmëri shoqërore individuale, lëvizshmëri shoqërore strukturore, ndryshim shoqëror, lëvizje shoqërore, shoqëri tradicionale, shoqëri moderne, shoqëri pasmoderne etj.

## 2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

### 2.1 Qëllimet e programit të sociologjisë

Lënda “Sociologjia” synon:

1. t’u ofrojë nxënësve njohuritë e nevojshme dhe t’u kultivojë aftësitë intelektuale për të analizuar dukuritë, proceset e zhvillimet më të rëndësishme të shoqërisë;
2. të kultivojë aftësitë për t’u angazhuar në zgjidhjen praktike të problemeve të ndryshme shoqërore që kanë të bëjnë me individin, me grupime shoqërore të caktuara ose me gjithë shoqërinë;
3. të kultivojë vetëdijen dhe përkushtimin për respektimin e vlerave, normave kulturore e ligjore si kusht i domosdoshëm për bashkëjetesën në shoqërinë bashkëkohore.

Misioni i lëndës sociologjia është zhvillimi i aftësive të tilla si:

- aftësia për të menduar në mënyrë kritike;
- aftësia për të menduar në mënyrë krijuese;
- aftësia për të zbatuar njohuritë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në jetën e përditshme;
- aftësia për të parashikuar ecurinë e proceseve të caktuara shoqërore në të ardhmen, së paku të afërt;
- aftësia për reflektime dhe arsyttime me vlerë morale e shoqërore.

Në misionin e kësaj lënde bëjnë pjesë edhe aftësitë për të kultivuar modele të sjelljeve shoqërore, si:

- aftësia për të përshtatur modele sjelljesh me të pëlqyeshme për shoqërinë ose të paktën për klasa ose shtresa të caktuara të saj;
- aftësia për t'u orientuar në procesin kompleks të komunikimit me anëtarë të subkulturave të ndryshme.
- aftësia për qenë sa më i efektshëm në angazhimet si veprimtar për zgjidhjen e problemeve shoqërore;
- aftësia për të parashtruar një problem shoqëror dhe për të argumentuar rrugëzgjdhjen e tij;
- aftësia për të parandaluar edhe tejkaluar konfliktet në bashkëveprimet e shumëllojshme me individë ose grupime shoqërore të caktuara;
- aftësia për t'u orientuar në shoqëritë dhe sistemet e tjera kulturore, kur mund të punojë e jetojë si student, si emigrant etj.;
- aftësia për të çmuar me frymë relativiteti vlerat, normat dhe elementet e tjera të sistemeve kulturore të vendeve të tjera;
- aftësia për t'u orientuar drejt lëvizjeve shoqërore përparimtare.

Përveç përvetësimit të koncepteve dhe të vlerave kryesore, aftësimi për t'u orientuar dhe për t'u angazhuar në veprimtari të ndryshme shoqërore, politike e kulturore, “Sociologjia” synon të kultivojë edhe qëndrime të caktuara, ndjenjën e përkushtimit për t'u angazhuar gjithnjë në anën më të përparuar të çdo fushe të jetës e të veprimtarisë, ndjenjën e përkushtimit ndaj vlerave me rëndësi jetike për ekzistencën dhe funksionimin e shoqërisë si:

- bindja për zbatimin me korrektësi të kërkesave të vlerave dhe të normave kulturore dhe ligjore sunduese në shoqëri;
- bindja se funksionimi normal i shoqërisë bazohet kryesisht në veprimtarinë paqësore të individëve dhe të grupeve shoqërore;
- bindja se është detyrë e çdo anëtari të shoqërisë të ndihmojë në forma të ndryshme për kapërcimin e dukurive e të problemeve që shqetësojnë shoqërinë, grupe të caktuara e deri individuale të veçantë;

- kultivimi i shpirtit kritik dhe kundërshtues ndaj të gjithë formave të paragjykimeve dhe diskriminimeve që kanë të bëjnë me përkatësinë gjinore, racore, etnike, kulturore, subkulturore etj.
- vlerësimi i elementeve përparimtare të çdo kulture dhe çdo shoqërie si pasuri e gjithë njerëzimit etj.


### **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

Në përfundim të këtij programi nxënësit të jenë të aftë:

- të shpjegojnë aspektet kryesore të funksionimit të shoqërisë mbi bazën e koncepteve sociologjike
- të përshkruajnë veçoritë specifike të funksionimit të shoqërisë shqiptare të ditëve tona;
- të përdorin strukturat konceptuale sociologjike për të analizuar dukuritë dhe zhvillimet shoqërore;
- të shpjegojnë se në procesin e shoqërizimit njerëzit ndryshojnë disa statuse dhe role në shoqëri; ndryshojnë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tjerëve etj.;
- të përdorin njohuritë sociologjike në zgjidhjen sa më racionale të problemeve të tyre në jetën e përditshme si dhe të problemeve që u përkasin grupimeve shoqërore të caktuara;
- të integrohen në shoqëri të tjera, në sisteme të tjera kulturore;
- të krijojnë përvojën e vet sociologjike nëpërmjet të menduarit kritik, vëzhgimeve, anketimeve, intervistimeve të thjeshta, zgjidhjes praktike të problemeve të ndryshme shoqërore etj.



Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



## 2.2 Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe

### **Kompetenca qytetare**

*Programi i sociologjisë, si pjesë e fushës shoqëria dhe mjedisi, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.*

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënit të synuara nga programi i lëndës së sociologjisë nxisin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

### **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit**

Programi i *sociologjisë* krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj, në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si t'i vlerësojë këto burime dhe të kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënit. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.

### **Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.

Programi i *sociologjisë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

### **Kompetenca e të nxënit**

Për të mbështetur formimin sociologjik, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranoi mendimet ndryshe. Përdori gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

### **Kompetenca personale**

Programi i sociologjisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

### **Kompetenca digjitale**

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

## **2.3 Lidhja e lëndës së sociologjisë me temat ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së sociologjisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.

- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e sociologjisë, nxënësi ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë njerëzore.

Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë, ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

#### 2.4 Lidhjet e lëndës së sociologjisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

<b>Sociologjia</b>	<b>Matematika</b>
Metodat e kërkimit, devianca, shtresimi gjinor dhe familja, racat dhe etniciteti, urbanizimi.	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ llogarit koeficientë të ndryshëm si koeficienti i vrasjeve ose i vetëvrasjeve, llogarit peshën specifike (përqindjen) për çështje demografike, për dukuri të tjera sociale etj.;</li> <li>▪ paraqet në mënyrë grafike ecurinë e dukurive të ndryshme shoqërore etj.</li> </ul>
<b>Sociologjia</b>	<b>Biologjia</b>
Devianca, shtresimi gjinor dhe familja	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ shpjegon marrëdhënie specifike ndërmjet përbërjes biologjike dhe prirjeve për reagime të caktuara të njerëzve në situata shoqërore të veçanta;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan rolin e kromozomeve në përcaktimin e karakteristikave dhe të funksioneve të caktuara të organizmit të njeriut.</li> </ul>
<b>Sociologjia</b>	<b>Psikologjia</b>
Devianca, shoqërizimi, shtresimi gjinor dhe familja	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan “mekanizmat” psikologjike të ndikimit të nofkave përçuese në vetëperceptimin e njerëzve;</li> <li>▪ përshkruan ndikimet psikologjike të divorcit në jetën e ish-bashkëshortëve dhe sidomos të fëmijëve të tyre.</li> </ul>
<b>Sociologjia</b>	<b>Historia</b>
Analizë sociologjike e besimeve fetare, urbanizimi	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ parashtron ecurinë e zhvillimit të dukurive shoqërore më të rëndësishme, së paku gjatë periudhës moderne;</li> <li>▪ dallon dhe përzgjedh ato fakte historike që ilustrojnë më mirë idetë sociologjike.</li> </ul>
<b>Sociologjia</b>	<b>Letërsia</b>
Shoqërizimi, urbanizimi, shtresimi shoqëror dhe lëvizjet shoqërore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përmend vepra letrare, të cilat me nivel të lartë artistik pasqyrojnë ngjarje shoqërore të rëndësishme;</li> <li>▪ përmend vepra letrare, që me nivel të lartë artistik pasqyrojnë lëvizje shoqërore, të cilat kanë shënuar kthesa në historinë e shoqërisë.</li> </ul>

## 2.5 Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Procesi i të nxënit në fushën shoqëria dhe mjedisi, në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe si dhe, në sasinë dhe cilësinë e mundshme, të kompetencave të tjera.

Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatisin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme, për të zgjidhur konfliktet atje, atëherë dhe kur kjo është e nevojshme.

Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore, ekonomike, politike etj. dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

- ) Nxënësi njeh dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të sociologjisë për përgatitjen për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.
- ) Nxënësi argumenton rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t'u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë.
- ) Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke u bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të sociologjisë dhe të të drejtave të njeriut,.
- ) Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.
- ) Nxënësi përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.

- ) Nxënësi zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje.
- ) Nxënësi eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin.
- ) Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe evropian.
- ) Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë për ta realizuar atë.
- ) Nxënësi njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj., me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë.
- ) Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve.
- ) Nxënësi është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. Ai pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor.
- ) Nxënësi vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise.
- ) Nxënësi zhvillon vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë.



Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit, kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxëniet të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, mobilizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to. Këto tematika janë:

- ) Individët, grupet, shoqëria.
- ) Kultura.
- ) Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi.
- ) Pushteti, autoriteti, qeverisja.

## **2.6 Koha mësimore për tematikë**

Programi i lëndës së sociologjisë zhvillohet në 68 orë mësimore në vit. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shitesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

3. Tabela. Orët përkatëse mësimore të tematikave për klasën përgatitore

<b>Tematika</b>	<b>Orë të sugjeruara:</b>
KULTURA	10 orë
SHOQËRIZIMI	6 orë
DEVIANCA	8 orë
SHTRESIMI GJINOR DHE FAMILJA	7 orë
RACAT DHE ETNICITETI	6 orë
ANALIZA SOCIOLOGJIKE E BESIMEVE FETARE	9 orë
URBANIZIMI DHE KARAKTERISTIKAT E PUNËS NË SHOQËRITË MË TË URBANIZUARA	8 orë
SHTRESIMI I SHOQËRISË DHE LËVIZJET SHOQËRORE	6 orë
SHOQËRIA TRADICIONALE, MODERNE, PASModerne	4 orë
METODAT E KËRKIMIT SOCIOLOGJIK	4 orë
<b>Totali</b>	<b>68</b>

### 3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE

Në programin e sociologjisë janë paraqitur rezultatet e të nxënit sipas tematikave. Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj ose grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë autorët e teksteve dhe mësuesit). Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është *relativisht* rekomanduese.

#### TEMATIKA 1: KULTURA, INDIVIDITI, SHOQËRIA

Kultura ose sistemi kulturor i çdo shoqërie është një dukuri shumë komplekse, e cila ndikon dhe shprehet në të gjithë modelet e sjelljes të anëtarëve të saj. Çdo sistem kulturor ka veçoritë e veta specifike që shfaqen në pesë përbërësit kryesor të tij që janë: simbolet kulturore, gjuha, vlerat kulturore, normat kulturore dhe kultura materiale.

#### Rezultatet e të nxënit

#### Kultura

**Orë të sugjeruara: 10 orë**

Njohja e veçorive specifike të sistemeve kulturore jo vetëm i vetëdijëson anëtarët e kulturës për rëndësinë e kulturës së vet, por edhe i ndihmon të orientohen më mirë në sistemet e tjera kulturore. Një aftësim i tillë orientues bëhet gjithnjë më i domosdoshëm, ndërkohë që në kushtet e përforsimit të prirjeve globalizuese rritet numri dhe pesha specifike e njerëzve që, për arsye të ndryshme, punojnë e jetojnë në disa sisteme kulturore (p.sh. rreth 36 për qind e popullsisë së Republikës së Shqipërisë aktualisht punojnë e jetojnë si emigrantë në sisteme të tjera kulturore).

**Njohuri**

**Aftësi**

**Qëndrime dhe vlera**

Kultura	Nxënësi:	Nxënësi:
Vlera kulturore		) pranon larmimë kulturore;
Norma kulturore, ligjore etj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ shpjegon konceptin gjithëpërfshirës të kulturës;</li> <li>▪ përshkruan funksionet e kulturës në marrëdhëniet e njerëzve me natyrën, me njëri-tjetrin, me shoqërinë;</li> <li>▪ tregon kuptimin e simbolit kulturor, funksionet kryesore të simboleve kulturore dhe veçoritë kryesore të zhvillimit të tyre;</li> <li>▪ dallon simbole të veçanta të kulturës shqiptare, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në funksionimin e shoqërisë shqiptare;</li> <li>▪ përshkruan kuptimin e gjuhës si tërësi simbolesh kulturore;</li> <li>▪ përshkruan rolin e veçantë të gjuhës shqipe në shpjegimin e disa dukurive kulturore e gjuhësore të vendeve të tjera të Evropës;</li> <li>▪ tregon kuptimin e konceptit sociologjik të vlerave kulturore,</li> <li>▪ përmend disa vlera kryesore të kulturave perëndimore;</li> <li>▪ argumenton rolin e veçantë të vlerave kulturore të besës dhe të mikpritjes së shoqërisë tradicionale shqiptare;</li> <li>▪ shpjegon konceptin sociologjik të normave kulturore dhe shumëllojshmërinë e tyre; argumenton raportet ndërmjet normave kulturore dhe normave ligjore;</li> <li>▪ shpjegon rolin e veçantë të normave kulturore në funksionimin e shoqërisë tradicionale shqiptare;</li> <li>▪ përcakton konceptin sociologjik të nënkulturës dhe kundërkulturës;</li> <li>▪ argumenton se kultura shqiptare është mozaik nënkulturash dhe e zhvilluar në periudha të gjata</li> </ul>	) respekton larminë kulturore dhe nënkulturore;
Simbol kulturor		) argumenton rëndësinë e respektimit të larmisë kulturore dhe nënkulturore për bashkëjetesën dhe harmoninë shoqërore;
Gjuha		) orientohet me dinjitet në çdo sistem tjetër kulturor.
Individi		
Shoqëria, shoqëri tradicionale		
Nënkultura		
Relativiteti kulturor		
Etnocentrizmi, Ksenocentrizmi		
Asimilim		
Disimilim		
Etnicitet		
Edukim ndërkulturor		
Mirëkuptim ndërkulturor		
Etj.		

kohore si kundërkulturë; argumenton dhe ilustron me shembuj e fakte të qëmtuara nga jeta e përditshme;

- dallon vështirësitë kryesore (etnocentrizmi, ksenocentrizmi) me të cilat ndeshen njerëzit kur kalojnë nga njëri sistem kulturor te tjetri;
- përshkruan veçoritë kryesore të reagimit të shqiptarëve ndaj kulturave të tjera kryesisht nëpërmjet njohjes së përvojave jetësore të emigrantëve shqiptarë, të studentëve shqiptarë që studiojnë në vende të tjera;
- përshkruan rëndësinë teorike dhe praktike të relativitetit kulturor.
- përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit;
- përgatit një ese për një çështje të kulturës shqiptare.

## **TEMATIKA 2: SHOQËRIZIMI**

Shoqërizimi është një proces mjaft kompleks. Nëpërmjet shoqërizimit çdo njeri formon personalitetin e vet si njeri, profesionist, veprimtar shoqëror etj. Çdo fazë e shoqërizimit të individit ndikohet nga faktorë dhe mjedise socialkulturore të ndryshme, të cilët evoluojnë në rrjedhën e kohës dhe përgjatë cikleve të shoqërizimit të çdo individi.

Kjo temë ndihmon nxënësin të njohë ndikimet e veçanta të mjediseve dhe faktorëve të ndryshëm (familja, shkollimi, grupet e vogla të shoqeve dhe shokëve më të afërt, mjetet e komunikimit masiv, opinioni publik), si dhe të përshkruajë veçoritë e ndikimit të faktorëve të tillë në shoqërinë shqiptare të ditëve tona.

**Rezultatet e të nxënit****SHOQËRIZIMI****Orë të sugjeruara: 6 orë**

<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>	<b>Qëndrime dhe vlera</b>
Shoqërizimi, Procesi i shoqërizimit Vetja shoqërore Tjetri Faktor shoqëror Mjedis shoqëror Ciklet e jetës	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>▪ shpjegon kuptimin sociologjik të shoqërizimit në formimin e personalitetit të njeriut;</li><li>▪ jep disa shpjegime kryesore sociologjike të procesit të shoqërizimit (vetja shoqërore dhe marrja e rolit të tjetrit sipas xh. H. Mid, pikëpamja e Ç. H. Kult për shoqërinë si pasqyrë etj.);</li><li>▪ shpjegon ndikimet e veçanta të mjediseve dhe faktorëve të ndryshëm (familja, shkollimi, grupet e vogla të shoqeve dhe shokëve më të afërt, mjetet e komunikimit masiv, opinionin publik);</li><li>▪ përshkruan veçoritë e ndikimit të faktorëve të tillë në shoqërinë shqiptare të ditëve tona.</li><li>▪ përshkruan ndikimin e filmave me procese gjyqësore dhe me dhunë në procesin e shoqërizimit të adoleshentëve shqiptarë;</li><li>▪ përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërizimit në ciklet e jetës (fëmijëria, adoleshenca, moshë e rritur e hershme, moshë e pjekurisë dhe pleqëria);</li><li>▪ analizon veçoritë e shoqërizimit përgjatë cikleve të tillë të jetës në shoqërinë shqiptare.</li></ul>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>▪ njeh më mirë njerëzit e tjerë, sidomos ata me të cilët bashkëpunon më nga afër në jetën e përditshme;</li><li>▪ njeh më mirë vetveten dhe orientohet më mirë në çdo mjedis social;</li><li>▪ shmang komunikimet e vrazhda me të tjerët dhe veçanërisht konfliktimet;</li><li>▪ ndërton marrëdhënie korrekte me të tjerët edhe duke kuptuar veçoritë specifike të shoqërizimit të tyre.</li></ul>

- përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi, duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.

### **TEMATIKA 3: DEVIANCA**

Sjellja deviante është dukuri komplekse, e konstatuar në të gjitha shoqëritë dhe në të gjitha kohërat. Sjellja deviante ushtron ndikim të shumëllojshëm në dukuritë e proceset shoqërore, në zhvillimin e shoqërisë. Me qëllim që sjelljet deviante të jenë sa më pak problematike, është e nevojshme që nxënësi adoleshent t'i njohë ato dhe shpjegimet e tyre sociologjike, sidomos në shoqërinë shqiptare. Kjo temë ndihmon nxënësit të kuptojë sjelljen deviante si një dukuri komplekse dhe të eksplorojë ndikimin e shumëllojshëm të saj në dukuritë e proceset shoqërore.

#### **Rezultatet e të nxënit**

**DEVIANCA**

**Orë të sugjeruara: 8 orë**

**Njohuri**

**Aftësi**

**Qëndrime dhe vlera**

<p>Devianca</p> <p>Sjellja deviante. Deviancë parësore dhe dytësore</p> <p>Faktorë që përcaktojnë një model sjelljeje si deviante</p> <p>Krimi, tiparet e krimit:</p> <p>krimi kundër personit, krimi kundër pasurisë, krimi i urrejtjes ose i mërisë, krimi i “jakave të bardha” dhe i ashtuquajtur “krimi pa viktimë” etj.</p> <p>Kriminaliteti, viktimat e krimit</p> <p>Media dhe krimi</p> <p>Teoritë e ndryshme të shpjegimit të deviancës</p> <p>Funkione shoqërore të sjelljeve deviante, kufij moralë, uniteti shoqëror etj.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan e arsyeton karakterin relativ të sjelljeve deviante, faktorët dhe rrethanat socialkulturore kryesore që përcaktojnë nëse një model sjelljeje është deviant ose jo;</li> <li>▪ përshkruan pesë tipat kryesorë të krimit (krimi kundër personit, krimi kundër pasurisë, krimi i urrejtjes ose i mërisë, krimi i “jakave të bardha” dhe i ashtuquajtur “krimi pa viktimë”);</li> <li>▪ dallon format specifike të shfaqjes së krimeve të tilla në shoqërinë shqiptare të ditëve tona;</li> <li>▪ arsyeton prirjet përse meshkujt dhe të rinjtë janë më të kriminalizuar se femrat dhe burrat me moshë më të pjekur si në vendet e tjera, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë;</li> <li>▪ shpjegon ndikimet e filmave me dhunë dhe procese gjyqësore në modelet e sjelljes së të rinjve shqiptarë;</li> <li>▪ përshkruan si ndikojnë në sjelljet e atij filma të tillë;</li> <li>▪ përshkruan shpjegimet kryesore biologjike dhe gjenetike të deviancës;</li> <li>▪ shpjegon teorinë sociologjike të kontrollit të Trevis Hirshit dhe teorinë e etiketimit të Hauërd S. Beker për shpjegimin e deviancës;</li> <li>▪ shpjegon kuptimin e deviancës parësore dhe dytësore;</li> <li>▪ përshkruan funksionet kryesore shoqërore të sjelljeve deviante (pohimi i vlerave kulturore më të rëndësishme, përcaktimi i kufijve moralë, forcimi i unitetit shoqëror, faktor i rëndësishëm ndryshimesh shoqërore);</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ sillet më me korrektësi në marrëdhënie me të tjerët;</li> <li>▪ shmang konfliktimet me njerëzit me prirje deviante dhe kriminale;</li> <li>▪ ndihmon të afërmit, miqtë dhe shoqet e shokët për t’iu shmangur konflikteve me njerëzit e prirur kah sjelljet deviante dhe kriminale;</li> <li>▪ ndihmon të tjerët, veçanërisht të afërmit, miqtë e bashkënxënësit për të kufizuar sjelljet deviante në shoqëri, goftë dhe ato më pak problematike.</li> </ul>
---	--	--



- përshkruan veçori të funksioneve të tilla në shoqërinë shqiptare.
- përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit;
- përgatit një ese për një sjellje deviante që shqetëson më shumë të rinjtë adoleshentë.

#### TEMATIKA IV: SHITESIMI GJINOR DHE FAMILJA

Dallimet gjinore janë të pranishme pothuajse në të gjithë shoqëritë. Ndonëse kryejnë role plotësuese të domosdoshme për funksionimin normal dhe zhvillimin e shoqërisë, marrëdhëniet ndërmjet femrave dhe meshkujve, jo rrallë karakterizohen nga paragjyqime të ndërsjella dhe diskriminimi. Zbehja dhe tejkalmi i dukurive të tilla negative reflektohet edhe në harmonizimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve dhe përgjithësisht të anëtarëve të familjes, në pakësimin e divorceve e të anëve të errëta të jetës familjare etj.

#### Rezultatet e të nxënit

##### SHTRESIMI GJINOR DHE FAMILJA

Orë të sugjeruara: 7 orë

Njohuri	Aftësi	Qëndrime dhe vlera
	Nxënësi:	Nxënësi:

<p>Gjinia, roli i gjinive në shoqërinë shqiptare</p>		
<p>Pabarazia gjinore, ekuilibri social dhe politik</p>		
<p>Lëvizje feministe</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan format kryesore të shfaqjes së pabarazisë gjinore;</li> <li>▪ përshkruan rolin e veçantë të vajzave dhe grave në shoqërinë shqiptare si faktor që përmirëson komunikimin, si faktor ekuilibrimi në jetën politike etj;</li> <li>▪ rendit objektivat kryesore të lëvizjeve feministe;</li> <li>▪ dallon format kryesore të martesës (endogamia dhe ekzogamia, monogamia dhe poligamia) dhe përshkruan funksionet shoqërore të tyre;</li> <li>▪ rendin pikëpamjet kryesore për dilemën bashkëkohore: martesë apo bashkëjetesë;</li> <li>▪ përshkruan mendësitë kryesore të shoqërisë shqiptare për këtë dilemë;</li> <li>▪ rendit format kryesore të familjes;</li> <li>▪ përshkruan karakteristikat kryesore të familjes shqiptare;</li> <li>▪ shpjegon funksionet kryesore të familjes (shoqërizimi, rregullimi i marrëdhënieve seksuale, riprodhimi dhe nxitja emocionale e përkrahja ekonomike);</li> <li>▪ përshkruan veçoritë e funksioneve të tilla në shoqërinë shqiptare;</li> <li>▪ shpjegon dukurinë e divorcit dhe rrjedhojat shoqërore e psikokulturore të saj;</li> <li>▪ përshkruan veçoritë e divorcit në shoqërinë shqiptare;</li> <li>▪ parashtron vizionet kryesore për të ardhmen e familjes.</li> <li>▪ përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ mirëkupton dhe respekton të gjithë anëtarët e shoqërisë, veçanërisht ata me përkatësi gjinore tjetër;</li> <li>▪ përpiqet të luftojë paragjykimet e çfarëdolloji të formuara mbi baza gjinore;</li> <li>▪ respekton familjarët, të afërmit dhe përhap të tjerët idetë për vlerat e familjes në çdo aspekt të jetës së anëtarëve të saj;</li> <li>▪ ndihmon në forma të ndryshme fëmijët dhe të rinjtë, sidomos shoqet dhe shokët e shkollës me prindër të divorcuar për të tejkaluar rrjedhojat e shumanshme të divorcit, veçanërisht ato psikologjike.</li> </ul>
<p>Martesa, format e martesës, endogamia dhe ekzogamia, monogamia dhe poligamia.</p>		
<p>Funksionet shoqërore të formave të ndryshme të martesës</p>		
<p>Bashkëjetësia, bashkëjetesa në shoqërinë shqiptare</p>		
<p>Familja, format kryesore të familjes.</p>		
<p>Funksionet kryesore të familjes</p>		
<p>Veçoritë e funksioneve të familjes në shoqërinë shqiptare.</p>		

## TEMA V: RACAT DHE ETNICITETI

Fjala *etni* dhe sidomos fjala *racë* përdoret dendur në jetën e përditshme. Shpesh këto fjalë përdoren me kuptime të gabuara dhe krijojnë pështjellim rreth grupimeve të popullsisë që shënojnë. Për racat dhe etnitë dhe sidomos për marrëdhëniet ndërmjet tyre lënda “Sociologjia” ofron kuptime të sakta, të cilat i ndihmojnë nxënësit adoleshentë të klasës së XII të vetëdijesohen, jo vetëm për të mos rënë në kurthin e paragjykimeve racore ose etnike, por edhe për t’u bërë veprimtar shoqëror për komunikime e marrëdhënie sa më harmonike ndërmjet grupimeve shoqërore me përkatësi të ndryshme racore, etnike.

### Rezultatet e të nxënit

#### RACAT DHE ETNICITETI

Orë të sugjeruara: 6 orë

Njohuri	Aftësi	Qëndrime dhe vlera
<p>Racat (kaukazianët, mongoloidët, negroidët) dhe karakteristikat kryesore të tyre.</p> <p>Etniciteti, pakicat etnike dhe marrëdhëniet e tyre me popullsinë në shumicë.</p> <p>Paragjykime dhe diskriminime mbi baza racore dhe etnike.</p> <p>Marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqërinë</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>shpjegon kuptimin sociologjik të konceptit <i>racë</i>, <i>etnicitet</i>, <i>pakicë kombëtare</i> dhe <i>pakicë etnike</i>;</li><li>përshkruan paragjykimet dhe diskriminimet të formuara mbi baza racore dhe etnike;</li><li>argumenton pse marrëdhëniet ndërmjet grupeve racore dhe etnike shpesh karakterizohen nga forma të ndryshme paragjykimi dhe diskriminimi;</li><li>analizon katër format kryesore të marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne (pluralizmi, asimilimi, veçimi (vetveçimi) dhe shfarosja);</li></ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>mirëkupton njerëzit me përkatësi tjetër racore ose etnike;</li><li>respekton njerëzit me përkatësi tjetër racore ose etnike;</li><li>përpiqet të luftojë çdo formë paragjykimi dhe keqtrajtimi të njerëzve me përkatësi tjetër racore ose etnike nga ajo vetjake;</li><li>krijon marrëdhënie korrekte, harmonike me njerëz me përkatësi tjetër racore ose etnike.</li></ul>

<p>moderne (pluralizmi, asimilimi, veçimi, shfarosja).</p> <p>Veçori të marrëdhënieve të popullit shqiptar me pakicat kombëtare dhe grupet etnike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan veçoritë e marrëdhënieve të shqiptarëve me pakicat kombëtare ose etnike në vendin tonë;</li> <li>▪ përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.</li> </ul>	
--	--	--

**TEMA VI: ANALIZA SOCIOLOGJIKE E BESIMEVE FETARE**

Besimet fetare kanë qenë dhe janë të pranishme në të gjithë shoqëritë e studiuara deri në ditët tona. Ato paraqiten në forma të ndryshme dhe ndryshojnë në rrjedhën e kohës. Besimet fetare kanë kryer dhe kryejnë funksione të rëndësishme në shoqëri, ndaj dhe janë bërë objekt i shqyrtimeve sociologjike.

**Rezultatet e të nxënit**

**ANALIZA SOCIOLOGJIKE E BESIMEVE FETARE**

**Orë të sugjeruara: 9 orë**

<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>	<b>Qëndrime dhe vlera</b>
<p>Kuptimi sociologjik i fesë.</p> <p>Funksionet kryesore të fesë (forcimi i unitetit shoqëror; përcaktimi i kuptimit të jetës; faktor i kontrollit shoqëror;</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ analizon përcaktimet kryesore sociologjike të fesë;</li> <li>▪ përshkruan funksionet kryesore të besimeve fetare (forcimi i unitetit shoqëror; përcaktimi i kuptimit të</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ mirëkupton njerëzit me përkatësi të tjera fetare nga ajo vetjake;</li> <li>▪ respekton njerëzit me përkatësi të tjera fetare nga ajo vetjake;</li> </ul>

ndikime të karakterit shoqëror të të shenjtës).

Harmonia ndërfitare si vlerë e veçantë kulturore e shqiptarëve.

Tipat kryesorë të organizatave fetare (eklesia, dinominejshën, sekti dhe kulti).

Veçoritë kryesore të feve botërore (Krishtërimi, Islamizmi, Judaizmi, Hinduizmi, Budizmi dhe Konfucianizmi).

Prirjet kryesore të ndryshimit të besimeve fetare (shekullarizimi, laicizmi dhe fundamentalizimi) në shoqëritë moderne dhe në shoqërinë shqiptare.

Keqinterpretimet dhe keqpërdorimet kryesore të besimeve fetare.

jetës; faktor i kontrollit shoqëror; ndikime të karakterit shoqëror të të shenjtës);

- përshkruan si shfaqet veprimi i funksioneve të tilla në bashkësinë vendore ku jeton ai vetë ose të afërm të tij;
- analizon ndikimin e shumëllojshmërisë fetare ndër shqiptarë në pasurimin e mozaikut nënkulturor të kulturës shqiptare;
- përshkruan fakte që provojnë tolerancën, mirëkuptimin ndërfitar të shqiptarëve në ditët tona dhe në të kaluarën, së paku të afërt;
- përshkruan tipat kryesorë të organizatave fetare (eklesia, dinominejshën, sekti dhe kulti), ndryshimin e tyre në rrjedhën e kohës si shprehje e shndërrimeve politike e shoqërore;
- përshkruan veçoritë kryesore të 6 feve që konsiderohen fe botërore dhe funksionet e tyre shoqërore të veçanta në shoqëritë ku veprojnë;
- analizon prirjet kryesore të ndryshimit të besimeve fetare në shoqëri (shekullarizimi, laicizmi dhe fundamentalizimi); përshkruan veçoritë e shekullarizimit dhe të fundamentalizimit në shoqërinë shqiptare;
- analizon keqpërdorimet (keqinterpretimet e skajshme) kryesore të fesë për qëllime të caktuara ekonomike, politike etj. dhe rrjedhojat e tyre problematike në shoqëri;
- përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.

- përpiqet të luftojë paragjykimet dhe keqtrajtimet e njerëzve me përkatësi tjetër fetare nga ajo vetjake;
- krijon marrëdhënie korrekte, harmonike me njerëz me përkatësi tjetër fetare nga ajo vetjake;
- shpjegon me korrektësi keqinterpretime dhe keqpërdorime të besimeve fetare.

## TEMA VII: URBANIZIMI DHE KARAKTERISTIKAT E PUNËS NË SHOQËRITË MË TË URBANIZUARA

Urbanizimi është një dukuri komplekse përgjatë 10-12 mijë viteve të fundit. Kjo dukuri është përhapur dhe zhvilluar me ritme të shpejta përgjatë dy shekujve të fundit, duke përcaktuar ndryshime rrënjësore jo vetëm në peizazhin urban, por edhe në modelet e organizimit dhe të punës, të sjelljes dhe të të menduarit të shumicës dërrmuese të anëtarëve të shoqërisë.

Në shoqëritë industriale shumë të zhvilluara ose pasindustriale puna ka disa karakteristika kryesore, të cilat në mjaft aspekte dallohen aktualisht nga veçoritë e punës në shoqërinë shqiptare. Të rinjtë shqiptarë lipset të njohim karakteristika të tilla. Në procesin e integritimit në sistemin e ekonomive industriale të Evropës e më gjerë dhe ekonomia shqiptare do të profillohet shkallë-shkallë sipas modelit të tyre edhe në çështje të punës.

### Rezultatet e të nxënit

## URBANIZIMI DHE KARAKTERISTIKAT E PUNËS NË SHOQËRITË MË TË URBANIZUARA

Orë të sugjeruara: 8 orë

Njohuri	Aftësi	Qëndrime dhe vlera
Parakushtet e urbanizimit. Qytetet e para dhe ato paraindustriale në vendet e tjera dhe në hapësirën shqiptare. Industrializimi dhe zhvillimi urban.	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>▪ përshkruan parakushtet e urbanizimit dhe karakteristikat e qyteteve paraindustriale;</li><li>▪ përshkruan veçoritë e urbanizimit përgjatë periudhës së industrializimit;</li><li>▪ analizon dukuritë e prirjet kryesore të zhvillimeve urbane pas Luftës së Dytë Botërore</li></ul>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>▪ mirëkupton njerëzit me pikëpamje dhe sjellje të ndryshme nga ato vetjake të përcaktuara nga mjedisi urban ose fshatar ku jetojnë;</li><li>▪ përshat modele të ndryshme sjelljeje dhe komunikimi me njerëz të shoqërizuar në mjedise urbane ose fshatare;</li></ul>

Dukuri dhe prirje bashkëkohore të urbanizimit (shpërqendrimi urban, zona urbane, përtëritje, urbane, xhentrifikimi, eksurbanizimi).

Veçori të urbanizimit në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore.

Jeta shoqërore e qyteteve në dritën e interpretimeve sociologjike (Dallime të mënyrës urbane të jetesës nga ajo fshatare, urbanizimi si mënyrë jetese, ekologjia urbane).

Veçori kryesore të punës në shoqëritë më të industrializuara (pakësimi i punës së gjallë të njerëzve në bujqësi; rritja e peshës specifike të punëve “jakëbardhë”, shtimi i profesioneve shumë të kualifikuara dhe rritja e rëndësisë së tyre; pakësimi i peshës specifike të të vetëpunësuarve; papunësia; ekonomia e paligjshme; rritja e shkallës së diversitetit në vendin

(shpërqendrimi urban, zona urbane, përtëritje urbane, xhentrifikimi, eksurbanizim);

- përkrahet karakteristikat kryesore të urbanizimit në Shqipëri, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore;
- përkrahet interpretimet kryesore sociologjike të jetës shoqërore në qytete (dallimet e mënyrës urbane të jetesës nga mënyra rurale, urbanizimi si mënyrë jetese dhe ekologjia urbane);
- analizon karakteristikat kryesore të punës në shoqëritë më të urbanizuara ose më të industrializuara (pakësimi i punës së gjallë të njerëzve në bujqësi; rritja e peshës specifike të punëve “jakëbardhë”, shtimi i profesioneve shumë të kualifikuara dhe rritja e rëndësisë së tyre; pakësimi i peshës specifike të të vetëpunësuarve; papunësia; ekonomia e paligjshme; rritja e shkallës së diversitetit në vendin e punës; rritja e shkallës së përdorimit të teknologjive të informacionit);
- krahason përafrimet, dallimet dhe karakteristikat e kundërta të punës në shoqërinë shqiptare të ditëve tona dhe rrjedhojat e tyre;
- përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi, duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.

- përpiqet të neutralizojë paragjykimet përcmuese që kanë banorët e qytetit për ato të fshatit dhe anasjelltas;
- orientohet në tregun e punës në perspektivë, të afërt ose të largët.

e punës; rritja e shkallës së përdorimit të teknologjive të informacionit)		
<p align="center"><b>TEMA VIII: SHITRESIMI I SHOQËRISË DHE LËVIZJET SHOQËRORE</b></p> <p>Shoqëria nuk është një grumbullim njerëzish i paorganizuar. Së paku, që nga lashtësia klasike greke e romake çdo shoqëri është e përbërë nga grupime shoqërore të caktuara si kasta, klasa, shtresa shoqërore etj. Çdo shoqëri ndryshon edhe në sajë të përpjekjeve të njerëzve për të ndryshuar statusin e tyre në shoqëri, në sajë të përpjekjeve për të kaluar nga klasat ose shtresat me status më të ulët në ato me status më të lartë. Në periudha historike të caktuara, përpjekje të tilla për ndryshim statusesh shoqërore masivizohen, bëhen më të vetëdijshme dhe më të organizuara, shndërrohen në lëvizje shoqërore.</p>		
<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p> <p><b>SHITRESIMI I SHOQËRISË DHE LËVIZJET SHOQËRORE</b></p> <p><b>Orë të sugjeruara: 6 orë</b></p>		
<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>	<b>Qëndrime dhe vlera</b>
Shtresëzimi – karakteristikë e gjithë shoqërive.	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan karakteristikat kryesore të shtresimit shoqëror;</li> <li>▪ përshkruan karakteristikat kryesore të organizimit të shoqërisë në sistemin e kastave;</li> </ul>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ mirëkupton njerëzit me pikëpamje e sjellje të ndryshme të përcaktuara nga përkatësia e tyre e ndryshme klasore ose shtresore;</li> </ul>



Forma të ndryshme të shtresëzimit (sistemi i kastave dhe veçoritë e tij, sistemi i klasave dhe veçoritë e tij).

Lëvizshmëria shoqërore strukturore dhe individuale, meritokracia.

Klasat dhe shtresat në shoqëritë e vendeve më të urbanizuara (rasti i shoqërisë së SHBA).

Profilet kryesore të shtresëzimit në shoqërinë shqiptare.

Ndryshimi shoqëror dhe karakteristika të tij (i përgjithshëm dhe me veçori dalluese në çdo shoqëri; i qëllimshëm, por i paplanifikuar në të gjitha rrjedhojat; rrjedhoja kontradiktore dhe kohëzgjatje të ndryshme).

Tipat kryesore të lëvizjeve shoqërore (lëvizja alternative dhe ajo realizuese, lëvizja reformuese dhe ajo revolucionare).

Faza të lëvizjeve shoqërore, (shfaqja, masivizimi dhe

- përshkruan karakteristikat kryesore të organizimit të shoqërisë në sistemin e klasave;
  - analizon dukurinë e lëvizshmërisë shoqërore individuale e strukturore dhe veçoritë e tyre në sistemin e kastave e të klasave;
  - analizon veçoritë kryesore të klasave e shtresave në shoqërinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si një nga shoqëritë e mëdha më të urbanizuara;
  - analizon dukurinë e ndryshimit shoqëror dhe karakteristikat kryesore të tij (i përgjithshëm dhe me veçori dalluese në çdo shoqëri; përgjithësisht i qëllimshëm, por i paplanifikuar në të gjithë rrjedhojat; rrjedhoja kontradiktore dhe kohëzgjatje të ndryshme);
  - interpreton idetë sociologjike për lëvizjet shoqërore dhe trupat kryesore të lëvizjeve shoqërore (lëvizja alternative, lëvizje realizuese, lëvizja reformuese dhe revolucionare);
  - analizon veçoritë e lëvizjeve shoqërore në të katër fazat e zhvillimit të saj dhe arsyet kryesore të rënies së lëvizjes shoqërore.
  - përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit;
  - përgatit një ese sipas temës së përcaktuar në libër ose të përcaktuara nga mësuesja.
- orientohet për të përparuar statusin e vet në shoqëri, duke u përfshirë në rrjedhën e lëvizshmërisë strukturore dhe individuale;
  - orientohet për të qenë sa më i vlefshëm në të gjitha lëvizjet shoqërore përparimtare.

<p>urbanizimi, burokratizimi dhe rënia).</p> <p>Veçori të fazave të lëvizjeve shoqërore.</p>		
<p align="center"><b>TEMA IX: SHOQËRIA TRADICIONALE, MODERNE, PASModerNE</b></p> <p><b>Përshkrimi i linjës:</b> Shoqëritë ndryshojnë vazhdimisht në rrjedhën e kohës. Ndryshime të rëndësishme janë vërejtur përgjatë kalimit të shoqërive nga faza tradicionale, në atë moderne dhe pasmoderne. Një tablo e përmbledhur e karakteristikave kryesore të shoqërive në këto tri faza të zhvillimit jepet në mësimet e kësaj linje. Analizat përgjithësuese konkretizohen edhe me fakte e dukuri nga shoqëria shqiptare.</p>		
<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p> <p><b>SHOQËRIA TRADICIONALE, MODERNE, PASModerNE</b></p> <p><b>Orë të sugjeruara: 4 orë</b></p>		
<p><b>Njohuri</b></p>	<p><b>Aftësi</b></p>	<p><b>Qëndrime dhe vlera</b></p>
<p>Përcaktimi sociologjik i shoqërisë tradicionale dhe moderne.</p> <p>Dallimet kryesore ndërmjet shoqërisë moderne dhe</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan katër karakteristikat kryesore të shoqërisë moderne sipas Peter Bergerit (venitja e komuniteteve të vogla tradicionale; zgjerimi i mundësive për zgjedhje vetjake; zgjerimi i</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ mirëkupton pikëpamjet dhe sjelljet e ndryshme të njerëzve që jetojnë në shoqëri moderne të përparuara;</li> </ul>

tradicionale (venitja e komuniteteve të vogla tradicionale; zgjerimi i mundësive për zgjedhje vetjake; zgjerimi i spektrit të shumëllojshmërisë shoqërore; orientimi nga e ardhmja dhe rritja e vetëdijes së kohës).

Veçoritë kryesore të shoqërisë tradicionale shqiptare dhe dukuritë e prirjet kryesore të modernizimit të saj.

Veçoritë dhe sfidat kryesore të shoqërisë pasmoderne (rënia e modernitetit; zbehja e dritës së përparimit; shkenca nuk përballon zgjidhjen e çështjeve; intensifikimi i debateve kulturore; ndryshimi i vazhdueshëm i institucioneve shoqërore).

spektrit të shumëllojshmërisë shoqërore; orientimi nga e ardhmja dhe rritja e vetëdijes së kohës);

- përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërisë tradicionale të krahasuara me ato të shoqërisë moderne;
- përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërisë tradicionale shqiptare dhe dukuritë e prirjet kryesore të modernizimit të një shoqërie të tillë;
- analizon e interpreton pesë karakteristikat kryesore të shoqërisë pasmoderne (rënia e modernitetit; zbehja e dritës së përparimit; shkenca nuk përballon zgjidhjen e çështjeve; intensifikimi i debateve kulturore; ndryshimi i vazhdueshëm i institucioneve shoqërore).
- përshkruan një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.

- orientohet në përpjekjet për të zgjidhur sa më mirë problemet vetjake e shoqërore në dinamikën e shndërrimit të shoqërisë shqiptare nga tradicionale në moderne;
- mirëkupton veçoritë e pikëpamjeve dhe të sjelljeve të njerëzve që jetojnë në shoqërinë pasmoderne dhe përgatitet psikologjikisht për të përballuar sfida të tilla.

## TEMA X: METODAT E KËRKIMIT SOCIOLOGJIK

Metodat e kërkimeve sociologjike janë të shumëllojshme. Ato luajnë rol të pazëvendësueshëm për qëmtimin e fakteve shoqërore, për zbulimin e prirjeve të zhvillimit të dukurive, të proceseve shoqërore. Metodat e kërkimeve sociologjike zbatohen të “modifikuara” sipas veçorive specifike të çdo shoqërie. Edhe veçoritë specifike të shoqërisë shqiptare kanë përcaktuar profilin shqiptar të përdorimit të metodave të kërkimeve sociologjike. Njohja e metodave të tilla ndihmon jo vetëm sociologët, por edhe çdo nxënës të kuptojë më shpejt e më mirë dukuritë shoqërore, sidomos ato më të ndërlikuara.

### **Rezultatet e të nxënit**

### **METODAT E KËRKIMIT SOCIOLOGJIK**

**Orë të sugjeruara: 4 orë**

<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>	<b>Qëndrime dhe vlera</b>
<p>Dallimet ndërmjet metodave të kërkimit sociologjik dhe atyre në shkencat natyrore.</p> <p>Eksperimenti sociologjik, veçoritë dhe kufizimet kryesore të tij në shoqëri të tjera dhe ato shqiptare.</p> <p>Lloje të ndryshme të vëzhgimit sociologjik (vëzhgimi i pjesshëm dhe i përgjithshëm, vëzhgim sistematik dhe jo sistematik, vëzhgim i</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan karakteristikat kryesore të metodave të kërkimeve sociologjike;</li> <li>▪ përshkruan disa eksperimente sociologjike (eksperimenti në fabrikën Hawthorne dhe eksperimenti në burgun Stanford);</li> <li>▪ krahason përparësitë e kufizimet e një metode të kërkimit sociologjik;</li> <li>▪ përshkruan reagimet e veçanta të shqiptarëve nëse vihen në një situatë eksperimentale;</li> <li>▪ përshkruan llojet kryesore të vëzhgimeve sociologjike (vëzhgimi i pjesshëm dhe i përgjithshëm, vëzhgim sistematik dhe jo sistematik, vëzhgim i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë, vëzhgim pjesëmarrës dhe jo</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ vetëdijësohet për vështirësitë dhe rolin e studimeve sociologjike në zgjidhjen sa më të mirë të problemeve shoqërore;</li> <li>▪ ndihmon sociologët për të kryer studime sociologjike;</li> <li>▪ përdor metoda sociologjike për të kryer studime dhe për të gjetur zgjidhje më të mira për problemet vetjake, të të afërmeve dhe më gjerë.</li> </ul>

drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë, vëzhgim pjesëmarrës dhe jo pjesëmarrës).

Anketa sociologjike, përparësitë dhe kufizimet e përdorimit të saj edhe në shoqërinë shqiptare.

Intervista dhe roli i saj në studimet sociologjike.

Llojet e intervistave sociologjike (intervista e lirë, intervista e strukturuar dhe intervista gjysmë e strukturuar), përparësitë dhe kufizimet e përdorimit të tyre.

Dokumentet zyrtare e vetjake dhe ndihmesa e tyre në studimet sociologjike.

pjesëmarrës) dhe procedurën e realizimit të tyre në kushtet e shoqërisë shqiptare;

- përdor elementet kryesore të hartimit dhe të realizimit të anketës sociologjike;
- harton dhe realizon modele ankete sociologjike, duke pasur parasysh veçoritë e modelimit psikokulturor të shqiptarëve;
- përdor kriteret dhe kërkesat kryesore të kampionimit sociologjik, për të realizuar praktikisht kampionime sociologjike të thjeshta;
- përshkruan llojet kryesore të intervistave sociologjike (intervista e lirë, intervista e strukturuar dhe intervista gjysmë e strukturuar);
- realizon intervista të thjeshta, duke pasur parasysh veçoritë kryesore të formimit psikokulturor të shqiptarëve;
- përdor dokumente të ndryshme zyrtare dhe vetjake në studimet sociologjike në shoqërinë shqiptare;
- përdor për të lexuar dhe interpretuar nga pikëpamja sociologjike dokumente të ndryshme zyrtare ose vetjake;
- harton një anketë që synon të studiojë një problem rinor të adoleshencës;
- interpreton të dhënat e grumbulluara përmes një ankete të realizuar me nxënësit e klasës ose të shkollës (mund të realizohet edhe si punë në grup).

#### 4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përmbajtja e lëndës së sociologjisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- Z ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- Z shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve;
- Z pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- Z pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake;
- Z përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimit dhe të nxënësve, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar e sociologjik dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimit dhe të nxënësve, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm midis nxënësve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dalta nga nxënësit, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i nxënësve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Pretendimet e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufijve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen “disiplinën” mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione të ndryshme, këndvështrime të shumëllojshme nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të fëmijëve, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst lënda e sociologjisë ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si raste studimi sociologjike për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të pëmbushë kjo lëndë.

Në këtë kuptim “rastet e studimit” nga komuniteti shërbejnë si ura lidhëse midis formimit të nxënësve në shkollë dhe jetën reale që përballojnë, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruarit reflektohet natyrshëm në qëndrimet që nxënësi do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.

Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë në mësimdhëniet e tyre modele të ndryshme të saj, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimdhënies ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-nxënës, mjedis fizik, materiale didaktike, personale të mësuesit dhe nxënësit, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë nxënësit, ku puna në grupe është e rëndësishme, por e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

### **Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së sociologjisë?**

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- J) *Dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative; (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënit; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;
- J) *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimit dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- J) *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.*

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytëtarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- J) aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- J) aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- J) respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- J) aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;



- ) aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- ) bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- ) aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- ) gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësimë prej tyre;
- ) aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

### **Mjedisi i të nxënit të sociologjisë**

Të mësuarit e sociologjisë nxit një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal.

Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Të mësuarit e sociologjisë zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënit formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Të mësuarit e sociologjisë duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve socialë, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe të rinjve për t'u dëgjuar, duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike; duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e studimeve sociologjike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave; duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës, kritereve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të së drejtës për të shfrytëzuar TIK-un në fushën e edukimit për qytetari demokratike; duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjesisë shoqërore;

### **Nxënësit me nevoja të veçanta**

Programi i lëndës së sociologjisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënët e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që përputhet me stilet e të nxënët të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

#### *a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë*

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënët njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënët, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënësit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevojë të veçantë duhet të diskutohen herëpashere me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

*b) Nxënësit e talentuar*

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënësit brenda dhe jashtë shkollës.

## 5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësit shtrihet gjatë gjithë procesit mësimor dhe nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës. Vlerësimi është një proces kompleks që duhet të përmirësohet në mënyrë të pandërprerë në të gjithë treguesit e vet.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit të lëndës sociologjia dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva që nuk përshkruhen në program.

Mësuesi zhvillon mënyra vlerësimi të shumëllojshme dhe angazhon edhe nxënësit në këtë proces kompleks.

Vlerësimi bëhet për arritje individuale ose/dhe në grup, në klasë ose/dhe jashtë saj. Nëse nxënësit punojnë në grupe të vogla për objektiva të caktuara, mësuesi sqaron rëndësinë e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të çdo nxënësi në veçanti.

Nxënësi vlerësohet me notë ndërkohë që paraqet arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarish e punimesh të caktuara.

Në orët e lëndës sociologjia nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë për përvetësimin e njohurive dhe për realizimin e detyrave të ndryshme të lëndës jashtë klase.

Mësuesi duhet të vlerësojë, duke u sqaruar nxënësve pikësynimet dhe kriteret e vlerësimit.

Vlerësimi me shkrim synon të nxisë aftësimin e nxënësve për të komunikuar me shkrim sa më saktë njohuritë sociologjike. Vlerësimi me shkrim mund të realizohet në mënyrë tradicionale, me penë e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi planifikon provime me shkrim për njohuritë e disa mësimëve ose kapitujve, të cilat i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Përdoren lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet për objektiva të veçuar të të nxënësit deri tek ata komplekse që zgjasin një orë mësimore dhe

që përmbajnë pyetje që testojnë saktësinë e përvetësimit të koncepteve sociologjike, pyetje që kultivojnë të menduarit kritik, krijues, eseistik etj. Gjithashtu mësuesi vlerëson edhe paraqitjen me shkrim nga nxënësit të detyrave tematike, të projekteve kurrikulare etj.

Një formë e paraqitjes me shkrim nga nxënësi është edhe provimi përfundimtar.

Një formë vlerësimi dhe vetëvlerësimi është edhe portofoli i nxënësit, çka është një përmbledhje e tij në lëndën e sociologjisë përgjatë disa muajve ose gjithë vitit shkollor. Portofoli mund të përmbajë provime me shkrim, detyra për çështje të caktuara shoqërore, projekte kurrikulare, kaseta me intervista të incizuara, fotografi, filmime ngjarjesh të caktuara që ilustrojnë ide sociologjike të rëndësishme etj.

Përzgjedhjet për portofolin bëhet nga nxënësi, ndërkohë që mësuesi është në rolin e këshilluesit.

Në procesin e vlerësimit, është e domosdoshme që mësuesi të marrë parasysh edhe vështirësi të veçanta të dokumentuara zyrtarisht, si vështirësitë specifike që kanë në komunikimin me gojë ose me shkrim fëmijët e emigrantëve të kthyer në atdhe pas shumë vitesh etj. Në varësi nga aftësitë e secilit zbatohen forma të veçanta kontrolli me gojë ose me shkrim.

Nxënësit që kanë jetuar për disa vite në sisteme të tjera kulturore si bij ose bija të familjeve të emigrantëve në forma të ndryshme mund të ofrojnë edhe për nxënësit e tjerë të klasës përvojën e tyre të komunikimit ndërkulturor. Përvoja të tilla të gjalla janë shembuj që përvetësohen në mënyrë të natyrshme nga nxënësit adoleshentë.

### **Të veçanta**

Standardet e përmbajtjes së lëndës sociologjia përmbajnë katër elemente të lidhura me njëra-tjetrën: njohuritë, aftësitë intelektuale të reflektimit të thellë rreth çështjeve të ndryshme shoqërore, nxitjen e pjesëmarrjes në veprimtari shoqërore të shumëllojshme dhe edukimin e vetëdukimin me

frymën e qytetarisë. Të marra së bashku, këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e lëndës sociologjia dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në këtë lëndë.

### **I. Njohuritë qëndrojnë në qendër të sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen në pyetje të tilla si:**

- Çfarë roli të veçantë luan dija sociologjike në shpjegimin e dukurive shoqërore?
- Si ndikon përparimi i kulturës në zhvillimin dhe humanizimin e shoqërisë?
- Cilat janë funksionet kryesore shoqërore të sjelljeve deviante?
- Si ndikojnë paragjykimet të ndryshme në modelet e sjelljeve të njerëzve?

**II. Aftësitë intelektuale** që kultivon lënda “Sociologjia” përfshijnë përdorimin e njohurive, të koncepteve për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese, për të realizuar studime të thjeshta për dukuri e çështje shoqërore, për të formuluar rekomandime për rrugëzgjdhje të problemeve të ndryshme shoqërore, që kanë të bëjnë me interesa të individit ose të grupimeve shoqërore.

**III. Aftësitë pjesëmarrëse** që kultivon lënda “Sociologjia” shprehen si përpjekje për t’u angazhuar në jetën publike, shoqërore, duke diskutuar në mjedise të gjera publike ide dhe interesa të caktuara të grupimeve shoqërore, duke bashkëpunuar me të tjerët në veprimtari të ndryshme, shoqërore, politike dhe kulturorë-artistike, duke u angazhuar në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në frymën e tolerancës e të mirëkuptimit etj.

Në vlerësimin e nxënësve në lëndën sociologjia është mirë të mbahen parasysh edhe refleksionet e tyre për veprimtari të ndryshme shoqërore jashtë mjediseve të shkollës, sidomos në ato me profil altruizmi më të spikatur si veprimtaria vullnetare, ku nxënësit janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë. **Theksojmë se nuk do të vlerësohet pjesëmarrje e nxënësit, por aftësitë e tij vetjake intelektuale për të reflektuar rreth veprimtarive të tilla.**

Përreth formimit teorik-intelektual lënda “Sociologjia” do të ndikojë edhe shoqërizimin e nxënësve adoleshentë me cilësitë më të mira të veprimtarit shoqëror me personalitet të afirmuar, si: dinjiteti vetjak, aftësia për të gjykuar në mënyrë të pavarur rreth problemeve të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë, aftësitë për t’u pozicionuar në anën e grupimeve shoqërore që ofrojnë zgjidhje më përparimtare, aftësia për t’u informuar në mënyrë dinamike për zhvillimet shoqërore në vendin tonë dhe në vendet më me ndikim në shkallë botërore, aftësia për të nxjerrë përfundime teorike e praktike nga lëvizje të ndryshme shoqërore, vetëdija për të zbatuar me korrektësi normat kulturore e ligjore sunduese të shoqërisë etj.

Natyrisht, **nxënësi nuk do të vlerësohet për modelet e sjelljeve të tij vetjake, por për argumentimin e domosdoshmërisë së modeleve të sjelljeve të caktuara në mjedise përkatëse etj.**

Përvetësimi i njohurive sociologjike, kultivimi i aftësive intelektuale dhe motivimi për t’u përfshirë në veprimtari shoqërore të shumëllojshme realizohen në mjedise të ndryshme si shkolla, familja, bashkësia e banorëve të lagjes etj. Këto përbëjnë fushat kryesore në të cilat fitohen njohuritë e aftësitë dhe njëherazi zbatohen në praktikë. Në rrethana të tilla një mundësi e mirë për të vlerësuar aftësitë intelektuale në procesin e zbatimit të njohurive dhe të pjesëmarrjes në veprimtari shoqërore janë projektet që përfundojnë në një produkt të caktuar si një portofol individual, grupi ose

klase, realizimi i një konkurimi në nivel klase, shkolle ose edhe më gjerë ku nxënësit të paraqesin ese analitike për probleme të caktuara të zhvillimit të shoqërisë shqiptare etj.



## 6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën shoqëria dhe mjedisi ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

### **Sugjerime për përdorimin e TIK**

Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.

Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet web për njohuri për shoqërinë.

Përdorimi i CD-ROM-it për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.

Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm software-sh.

Përdorimi i simulimeve software.

Përdorimi i grafikëve software.

Paraqitja grafike e të dhënave.